# VERTIMEC 1,8 EC

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



"KUJDES"

*"Lexo etiketen para përdorimit"*

I DESTINUAR VETËM PËR PËRDORUESIT PROFESIONISTË.

**VERTIMEC 1,8 EC** është akaricid - insekticid, me veprim të brendshëm dhe kontakti.

**Lënda vepruese**: *Abamectin 1,8 %*
**Formulimi:** *Koncentrat i emulsionueshem (EC)*

**Deklaratat e rrezikut**
H302: E dëmshme nëse gëlltitet.
H319: Shkakton irritim të rëndë syri.
H335: Mund të shkaktojë irritim në frymëmarrje.
H373: Mund të shkaktojë dëme në organe pas ekspozimit të tejzgjatur ose të përsëritur. Përmban abamectin dhe Cyclohexanol.
EUH401: Për të shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimiet për përdorimin.

**Deklarata parandaluese (Reagimi)**
P405+102: Magazinojeni të kyçur. Mbajeni larg fëmijëve.

P270: Mos hani ushqim, pini lëngje ose duhan kur përdorni këtë produkt.

P260: Mos thithni mjegullën e spërkatjes.

P264: Lani me kujdes lëkurën par trajtimit.

P280: Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/pajisje mbrojtëse personale për sytë/fytyrën. Vishni veshje të plota mbrojtëse, çizme dhe doreza kur përzieni/ngarkoni dhe spërkatni Vishni uniformë pune kur rihyni në parcelat e trajtuara përpara se të thahet lëngu spërkatës.

P501: Hidheni përmbajtjen/kontejnerin sipas ligjit kombëtar.

**Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:**
Mbani në dispozicion paketimin, etiketën ose MSDS e produktit në rast se kërkoni ndihmë nga mjeku ose nga Qendra e Helmimeve.
P314: Konsultohuni/vizitohuni tek mjeku nëse nuk ndiheni mirë.
P305+P351+P338: NË RAST KONTAKTI ME SYTË: Shpëllajini me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse keni. Vazhdoni shpëlarjen.
P337+P313: Nëse irritimi i syve vazhdon: Konsultohuni/Vizitoni një mjek.
Në rast gëlltitje: Mos shkaktoni të vjella. Thërisni mjekun dhe tregojini etiketën.
Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni rrobat e ndotura dhe shpëlani pjesët e prekura të trupit me ujë. Nëse acarimi vazhdon, i telefononi mjekut. Lani rrobat e ndotura përpara se ti vishni përsëri.
P304+P340: NËSE MERRET ME ORGANËT E FRYMËMARRJES: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër dhe lëreni të pushojë në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen
P312: Telefononi një QENDËR HELMINI apo një doktor nëse nuk ndiheni mirë.
ANTIDOTI: Nuk ka antidot të njohur. Ndiqni trajtim simptomatik. Evitoni dhënjën e barbiturateve, benzodiazepinave dhe acidit valproik. Në rast gëlltitje, jepni 2-3 gota ujë dhe shkaktoni të vjella, vetëm nëse pacienti nuk ka humbur ndjenjat, me irritim të faringut.

**Perdorimi:**

| **Kulturat bujqësore** | **Dëmtuesit** | **Dozat** | | | **Mënyra dhe koha e trajtimit** | **Nr maksimal i trajtimeve/sezon kultivimi/ Intervali i trajtimeve në ditë** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **ml/ dynym (max)** | **ml/ 100 litra ujë** | **Sasia e tretësirës spërkatës e/dynym** | | |
| Bimë | **Këpushat:** | 100 | 75-100 | 100 | Spërkatje gjethore në | Deri në 4 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| zbukuruese (S) (bimë, bulba dhe bimë bulbore me lule, pemë, shkurre dhe fidanishte të pemëve pyjore). | *Tetranychus urticae, Eriophyes spp.* **Liriomiza:** *Liriomyza trifolii* **Tripsi:** *Frankliniella occidentalis* **Pleshtat:** *Psylla spp* | | | | fillim të infektimeve | trajtime me interval 7 ditë |
| Domatja (S) | **Këpushat:** *Tetranychus urticae, Aculops lycopersici* **Liriomizat:** *Liriomyza sp.* **Tripset:** *Frankliniella occidentalis, Thrips sp* | 120 | 80-100 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para. Nga shfaqja e gjethes së 2të të vërtetë në degën kryesore deri në pjekjen e plotë të frutave. (BBCH 12-89 ). | Deri në 2 trajtime me interval 7 ditë |
| Patëllxhani (S) | **Këpushat:** *Tetranychus urticae, Aculops lycopersici* **Liriomizat:** *Liriomyza sp.* **Tripset:** *Frankliniella occidentalis, Thrips sp* | 120 | 80-100 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para. Nga shfaqja e gjethes së 2të të vërtetë në degën kryesore deri në pjekjen e plotë të frutave. (BBCH 12-89 ). | Deri në 4 trajtime me interval 7 ditë |
| Speci (S) | **Këpushat:** *Tetranychus urticae, Aculops lycopersici* **Liriomizat:** *Liriomyza sp.* **Tripset:** *Frankliniella occidentalis, Thrips* sp | 120 | 80-100 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para. Nga shfaqja e gjethes së 2të të vërtetë në degën kryesore deri në pjekjen e plotë të frutave. (BBCH 12-89 ). | Deri në 2 trajtime me interval 7 ditë |
| Kastraveci (S) Kungulli (S) | **Këpusha:** *Tetranychus urticae* **Liriomizat:** *Liriomyza sp.* **Tripset:** *Frankliniella occidentalis, Thrips sp* | 120 | 80-100 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para dhe të këpushave të para. Dozat e mëdha të përdoren për të luftuar popullatat e mëdha të dëmtuesve. Nga shfaqja e kotiledoneve deri në pjekjen e plotë të frutave (BBCH 10-89). | Deri në 2 trajtime me interval 7 ditë |
| Pjepri (S) Shalqiri (S) | **Këpusha:** *Tetranychus urticae* **Liriomizat:** *Liriomyza sp* **Tripset:** *Frankliniella occidentalis Thrips sp* | 120 | 80-100 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para dhe të këpushave të para. Dozat e mëdha të përdoren për të luftuar popullatat e mëdha të dëmtuesve. Nga shfaqja e kotiledoneve deri në pjekjen e plotë të frutave (BBCH 10-89). | Deri në 3 trajtime me interval 7 ditë |
| Luleshtrydhja (S) | **Këpushat:** *Tetranychus spp.* | 30-80 | 60 | 50-120 | Spërkatje gjethore me shfaqjen e simptomave të para dhe të këpushave të para. | Deri në 2 trajtime me interval 7 ditë |

*Mënyra e veprimit:*
Produkti përmban abamectin, që i përket grupit 6 sipas IRAC (aktivizues të kanalit të klorit). Shkakton paralizë të insekteve, të cilët ndalojnë procesin e të ushqyerit dhe ngordhin pas 2-4 ditësh. Ka veprim të fuqishëm kontakti dhe translaminar dhe veprim të kufizuar sistemik.
*Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse:*
Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe duke vazhduar përzierjen shtoni dozën e produktit dhe aty ku rekomandohet vajin mineral. Plotësoni me sasinë tjetër të ujit duke vazhduar përzierjen.

*Pastrimi i mjeteve të spërkatjes:*
Zbrazni plotësisht rezervuarin e pompës spërkatëse. Sigurohuni që të jenë hequr të gjitha gjurmët e produktit Shpëlani tre (3) herë me ujë të pastër rezervuarin dhe të gjitha pjesët e makinës spërkatëse.
*Udhëzime për tërheqjen e sigurt të produktit dhe paketimit:*
Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëlarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.
Produkti nuk duhet të përdoret në kulturat e ngrënshme në serra të gjatë muajve të dimrit (nëntor - shkurt), duke përjashtuar kulturat e domates dhe patëllxhanit.

**Periudha e sigurisë midis trajtimit dhe rifutjes së njerëzve ose të kafshëve në zonën e trajtuar**:
Deri sa të thahet plotësisht tretësira spërkatëse në sipërfaqen e gjetheve.

**Verejtje per perdorimin:**
Nuk rekomandohet përzierja me preparate të tjera. Lejohet vetëm për përdorime që lejojnë shkëmbimin e kontrolluar të materialit dhe energjisë me mjedisin përreth dhe parandalojnë lëshimin e produktit në mjedis, veçanërisht përdorimet në serra të përhershme.
*Menaxhimi i rezistencës:*
Produkti përmban abamectin, që i përket grupit 6 sipas IRAC. Për të shmangur zhvillimin e rezistencës, rekomandohet alternimi me insekticide nga grupe të tjera me mënyrë tjetër veprimi.

**Fitotoksiciteti:**
Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara ne kete etikete.

**Ndikimi ne ekosistem:**
H410: Shumë toksik për jetën ujore me efekte afatgjata. Përmban cikloheksanol dhe hydroxytoluene të butilizuar. Evitoni shpërndarjen e tretësirës spërkatëse në sipërfaqet ujore.
SP1: Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij. Mos i lani pajisjet e spërkatjes pranë ujrave sipërfaqësore.
SPe3: Për të mbrojtur organizmat ujorë dhe organizmat jo objekt luftimi të zbatohen masat e mëposhtme mbrojtëse:
- Për trajtimet në kulturat gjethegjera dhe perime, lini një zonë mbrojtëse të paspërkatur prej 10 m.
- Për trajtimet e kulturave të tjera lini një zonë 30 m të pa spërkatur ose alternativisht një zonë 15 m të paspërkatur në kombinim me përdorimin e sprucatorëve që ulin 90% shpërndarjen e lëngut spërkatës.
SPe3: Për të mbrojtur artropodët jo objekt luftimi të zbatohen masat e mëposhtme mbrojtëse:
- Për trajtimet në kulturat gjethegjera dhe perime, lini një zonë 5 m të pa spërkatur, nga tokat e papunuara.
Spe8: Mundësisht e rrezikshme për bletët. Për të mbrojtur bletët dhe insektet e tjera pjalmuese, mos e përdorni produktin në kulturat bujqësore gjatë lulëzimit ose gjatë periudhës së lulëzimit të barërave të këqija. Mos e përdorni produktin gjatë sezonit kur bletët janë duke punuar. Për të mbrojtur bletët, bletarët në zonë duhet të informohen në mënyrë që bletët të largohen nga zona për të paktën: 43 orë nga koha e trajtimit në kulturën e domates në fushë të hapur; 96 orë nga momenti i trajtimit në kulturat e serrave për të vendosur pjalmues/bletë në serra.

**Trajtimi i fundit para vjeljes:**

| Prodhime bimore | Ditë |
|---|---|
| Domatja (S), Patëllxhani (S), Kastraveci (S), Kungulli (S), Pjepri (S), Shalqiri (S), Luleshtrydhja (S) | 3 |
| Speci (S) | 7 |
| Bimë zbukuruese (S) (bimë, bulba dhe bimë bulbore me lule, pemë, shkurre dhe fidanishte të pemëve pyjore). | Nuk përcaktohet |

**Magazinimi:**
Ai mbetet i qëndrueshëm për të paktën dy (2) vjet nëse mbahet në paketimin e tij origjinal, të mbyllur, larg zjarrit ose burimeve të tjera të nxehtësisë, në një vend të thatë, të freskët dhe të ajrosur mirë.

Nr dhe data e regjistrimit: 181/3, datë 6.12.2023;
Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 10 ml deri në 5 litër;
Data e prodhimit........................................................................................... ;
Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 2 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese.........................;
Tipi i amballazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene) dhe f-HDPE;
Emri dhe adresa e kerkuesit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Switzerland;
Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Switzerland.
Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise): .....